



VENDIM

Nr.613, datë 29.07.2020

PËRDISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR.4/2020, “PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Objekti**

Ky vendim parashikon rregullat dhe procedurat për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

Neni 2 **Interpretimi**

Standardi i raportimit tëpërbashkët dhe komentaret e tij, të miratuar nga Këshilli i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, më 15 korrik 2014, të ndryshuar, do të aplikohen për qëllim të interpretimit të këtij vendimi.

Neni 3 **Përkufizime**

Për qëllim të interpretimit të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aktiv financiar” përfshin një letër me vlerë (për shembull, një përqindje aksionesh në një korporatë, partneritet ose interes përfitimi nga pronësia në një trust ose shoqëri tregtare me shumë aksionarë ose të kuotuar në bursë; dëftesë, bono, instrumente borxhi ose evidenca të tjera borxhi), interesin e partnerit në partneritet, mallra, marrëveshje shkëmbimi *swap*, kontratat e sigurimeve ose kontratat e pensionit vjetor ose çdo interes në letra me vlerë, interes partneriteti, mallra, *swap*, kontratë sigurimesh ose kontratë pensioni vjetor. “Aktivi financiar” nuk përfshin një interes të drejtpërdrejtë jodebitor në pasuri të paluajtshme.

2. “Bankë qendrore”, një institucion, që me ligj ose akt shtetëror është autoriteti kryesor, që përveç qeverisë së vetë juridiksionit, emeton instrumente që kanë për qëllim të qarkullohen si

monedhë. Ky institucion mund të përfshijë një organizëm që është i ndarë nga qeveria e juridiksionit, pavarësisht nëse zotërohet apo jo plotësisht ose pjesërisht nga juridiksioni.

3. “CTS”, sistemi i krijuar nga OECD-ja, që bën të mundur shkëmbimin automatik të informacionit ndërmjet autoriteteve tatimore sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit.

4. “Emetues i kualifikuar i kartave të kreditit”, institucioni financiar që përmbush kriteret e mëposhtme:

a) institucioni financiar është një institucion financiar vetëm sepse është emetues i kartave të kreditit, që pranon depozita vetëm kur klienti kryen pagesa që tejkalojnë balancën e përcaktuar për kartën dhe kjo mbipagesë nuk i rimbursohet menjëherë klientit; dhe

b) duke filluar më ose përpara datës 1 korrik 2019, institucioni financiar zbaton politika dhe procedura qoftë për ta ndaluar klientin që të kryejë mbipagesa që i tejkalojnë 50 000 USD ose për të garantuar se çdo mbipagesë e klientit, që e tejkalon vlerën 50 000 USD, t’i rimbursohet klientit brenda 60 ditëve, në çdo rast, duke zbatuar rregullat e parashtruara në pikën 3, të nenit 10, për totalizimin e llogarisë dhe konvertimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk u referohet balancave të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara, por përfshijnë balancat e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.

5. “Evidenca shkresore” përfshin pikat e mëposhtme:

a) certifikatën e rezidencës të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjencia e saj, ose bashkia) i juridiksionit në të cilin paguesi pretendon se është rezident;

b) lidhur me individin, çdo identifikim i vlefshëm i lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjencia e saj, ose bashkia), që përfshin emrin e individit dhe zakonisht përdoret për qëllime identifikimi;

c) lidhur me njësinë ekonomike, çdo dokument zyrtar i lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjencia e saj, ose bashkia) që përfshin emrin e njësisë ekonomike, si dhe adresën e selisë së saj qendrore në juridiksionin në të cilin pretendon se është rezidente ose juridiksionin në të cilin njësia ekonomike ishte themeluar ose organizuar;

ç) çdo pasqyrë financiare e audituar, raport kredie i palëve të treta, aplikim për faliment ose raport i rregullatorit të letrave me vlerë.

Për sa i përket një llogarie të një njësie ekonomike ekzistuese, institucionet financiare raportuese mund të përdorin si evidenca shkresore çdo klasifikim në të dhënat e institucionit financiar raportues, në lidhje me mbajtësin e llogarisë që është përcaktuar në bazë të një sistemi të standardizuar të kodimit të industrisë, që është regjistruar nga institucioni financiar raportues, në përputhje me praktikat e tij normale të biznesit për qëllimet e procedurave të PPP-së/NJKT-sëose për qëllime të tjera rregullatore (përveç qëllimeve tatimore) dhe që është zbatuar nga institucioni financiar raportues para datës së përdorur për klasifikimin e llogarisë financiare, si llogari paraekzistuese, me kusht që institucioni financiar raportues nuk e di ose nuk ka arsye të dijë që një klasifikim i tillë është i pasaktë ose jo i besueshëm.

6. “Fond/njësi ekonomike investimesh”, çdo njësi ekonomike:

a) që kryesisht drejton si biznes një ose më shumë prej veprimtarive ose operacioneve vijuese për llogari ose në emër të një klienti, të tilla si:

i. tregti në instrumentet e tregut të parasë (çeqe, kambiale, certifikata depozite, derivativë etj.); këmbim valutor; këmbim, normë interesi dhe instrumente indeksi; letra me vlerë të transferueshme; ose transaksione me kontratat e së ardhmes (future) për mallrat;

ii. menaxhim të portofolave individualë dhe kolektivë; ose

iii. gjithashtu, investon, administron ose menaxhon aktivet financiare ose paratë për llogari të personave të tjerë; ose

b) të ardhurat bruto të së cilës u atribuohen, kryesisht, investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare, nëse njësia ekonomike menaxhohet nga një tjetër njësi ekonomike që është një institucion depozite, institucion kujdestarie, shoqëri sigurimesh e specifikuar ose një njësi ekonomike investimesh e përshkruar në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni. Një njësi ekonomike “menaxhohet” nga një njësi ekonomike tjetër nëse njësia ekonomike menaxhuese kryen, drejtpërdrejt ose përmes një ofruesi tjetër shërbimi, ndonjë prej

aktiviteteve ose veprimtarive të përshkruara në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni, në emër të njësisë ekonomike të menaxhuar. Sidoqoftë, një njësi ekonomike nuk menaxhon një njësi ekonomike tjetër, nëse nuk ka autoritet për të menaxhuar pasuritë e njësisë ekonomike (tërësisht ose pjesërisht). Kur një njësi ekonomike menaxhohet nga një përzierje e institucioneve financiare, njësi ekonomike jofinanciare ose individëve, njësi ekonomike konsiderohet se menaxhohet nga një njësi ekonomike tjetër, që është një institucion depozitues, një institucion kujdestarie, një shoqëri sigurimesh ose një fond/njësi investimesh e përshkruar në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni, nëse ndonjë prej njësi ekonomike është kjo njësi ekonomike tjetër.

6.1 Njësi ekonomike trajtohet se po kryen kryesisht si biznes një ose më shumë prej veprimtarive të përshkruara në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni, ose të ardhurat bruto të njësisë ekonomike u atribuohen, kryesisht, investimeve, rinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare, për qëllime të shkronjës “b”, të pikës 6, të këtij neni, nëse të ardhurat bruto të njësisë ekonomike, që u atribuohen veprimtarive përkatëse, janë të barabarta ose i tejkalojnë 50% të të ardhurave bruto të njësisë ekonomike, në më pak se:

a) periudha trevjeçare që përfundon më 31 dhjetor të vitit që vjen përpara vitit në të cilin është bërë përcaktimi; ose

b) periudha gjatë së cilës njësi ekonomike ka ekzistuar. “Njësi ekonomike investimi” nuk përfshin njësinë ekonomike që është një NFE aktive, sepse ajo përmbush të gjitha kriteret e shkronjave “d”, “dh”, “e”, “ë”, të pikës 41, të këtij neni. Ky paragraf do të interpretohet në një mënyrë të pajtueshme me terminologjinë e ngjashme të parashtuar në përkufizimin e “institucionit financiar” në rekomandimet e Task-Forcës për Aksionin Financiar.

7. “Fond pensioni i një organi qeveritar, organizate ndërkombëtare ose bankeqendrore”, fondi i krijuar nga organi qeveritar, organizata ndërkombëtare ose Banka Qendrore për të dhënë pensione pleqërie, invaliditeti ose familjar për përfituesit, ose pjesëmarrësit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të caktuar nga këta punëmarrës) ose që nuk janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm, nëse pensionet që u jepen këtyre përfituesve ose pjesëmarrësve janë në pajtim me shërbimet personale të realizuara për organin qeveritar, organizatën ndërkombëtare ose Bankën Qendrore.

8. “Fond pensioni me pjesëmarrje të gjerë”, fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar apo një kombinim të tyre për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që fondi:

a) të mos ketë asnjë përfitues të vetëm me të drejtë në më shumë se pesë për qind të aktiveve të fondit;

b) të jetë objekt i rregulloreve të qeverisë dhe të raportoje informacione pranë autoriteteve tatimore; dhe

c) të përmbushë të paktën një prej kriterëve të mëposhtme:

i. fondi është përgjithësisht i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat nga investimet ose tatimi i këtyre të ardhurave shtyhet ose tatohet me një normë të reduktuar, për shkak të statusit të tij si fond pensioni pleqërie ose fond pensioni;

ii. fondi merr të paktën 50% të kontributeve të tij totale (të ndryshme nga transfertat e aktiveve nga planet e tjera të përshkruara në pikat 9, 7, 4, të këtij neni ose nga llogaritë e pensionit të pleqërisë ose të pensionit, të përshkruara në shkronjën “a”, të pikës 27, të këtij neni, nga punëdhënësit sponsorizues;

iii. shpërndarjet ose tërheqjet nga fondi lejohen vetëm nëse ndodhin ngjarje të specifikuar lidhur me pensionin, invaliditetin ose vdekjen (me përjashtim të shpërndarjeve të cilat rinvestohen në fonde të tjera pensioni, të përshkruara në pikat 9, 7, 4 të këtij neni ose në llogaritë e pensionit të pleqërisë ose të pensionit, të përshkruara në shkronjën “a”, të pikës 27, të këtij neni, ose, në rast të shpërndarjeve ose të tërheqjeve të bëra përpara këtyre ngjarjeve të specifikuar, do të zbatohen penalitete; ose

iv. kontributet (me përjashtim të disa kontributeve kompensuese të autorizuara) nga punëmarrësit në fond janë të kufizuara në funksion të të ardhurave të punëmarrësit ose, në

zbatim të rregullave të parashtruara në pikën 3, të nenit 10, për totalizimin e llogarisë dhe konvertimin në monedhën vendëse, nuk mund t'i kalojnë 50 000 USD në vit.

9. “Fond pensioni me pjesëmarrje të kufizuar”, fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që:

- a) fondi të ketë më pak se 50 pjesëmarrës;
- b) fondi të sponsorizohet nga një ose më shumë punëdhënës të cilët nuk janë njësi ekonomike investimi ose NFE pasive;
- c) kontributet e punëmarrësit dhe të punëdhënësit në fond (me përjashtim të transfertave të aktiveve nga llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe të pensionit të përshkruara në shkronjën “a”, të pikës 27, të këtij neni, të jenë përkatësisht të kufizuara në funksion të të ardhurave të fituara dhe të kompensimit të punëmarrësit;
- ç) pjesëmarrësit që nuk janë rezidentë të juridiksionit ku është krijuar fondi të mos kenë të drejtën e më shumë se 20% të aktiveve të fondit; dhe
- d) fondi të jetë objekt i rregulloreve qeveritare dhe të raportojë informacion pranë autoritetit tatimor.

10. “Institucion depozite”, çdo njësi ekonomike që pranon depozita sipas mënyrës së zakonshme të një banke ose biznesi të ngjashëm.

11. “Institucion financiar”, një institucion kujdestarie, një institucion depozite, një njësi ekonomike investimesh ose një shoqëri sigurimesh specifike.

12. “Institucion financiar i juridiksionit” është:

- a) çdo institucion financiar që është rezident në juridiksionin pjesëmarrës, por përjashton çdo degë të atij institucioni financiar që ndodhet jashtë këtij juridiksioni pjesëmarrës; dhe
- b) çdo degë e një institucioni financiar që nuk është rezident në juridiksionin pjesëmarrës, nëse kjo degë është e vendosur në juridiksionin pjesëmarrës në fjalë.

13. “Institucion financiar i juridiksionit pjesëmarrës” është:

- a) çdo institucion financiar që është rezident në juridiksionin pjesëmarrës, por përjashton çdo degë të atij institucioni financiar që ndodhet jashtë këtij juridiksioni pjesëmarrës; dhe
- b) çdo degë e një institucioni financiar që nuk është rezident në juridiksionin pjesëmarrës, nëse kjo degë është e vendosur në juridiksionin pjesëmarrës në fjalë.

14. “Institucion financiar joraportues” është çdo institucion financiar, që:

- a) është një organ qeveritar, organizatë ndërkombëtare ose bankë qendrore, përveçse lidhur me pagesa të cilat rrjedhin nga detyrimet e mbajtura, në lidhje me një veprimtari financiare tregtare të llojit të atyre të realizuara nga një shoqëri sigurimesh e specifikuar, një institucion kujdestarie ose një institucion depozite;
- b) është një fond pensioni me pjesëmarrje të gjerë; një fond pensioni me pjesëmarrje të kufizuar; një fond pensioni i një organi qeveritar, organizate ndërkombëtare ose banke qendrore; ose një emetues i kualifikuar i kartave të kreditit;
- c) çdo njësi tjetër ekonomike që paraqet rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore, ka shumë karakteristika të ngjashme me secilën prej njësive të përshkruara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 14, të këtij neni, dhe është përcaktuar sipas shtojcës III bashkëlidhur këtij vendimi si një institucion financiar joraportues, me kusht që statusi i kësaj njësie si institucion financiar joraportues nuk cenon qëllimet e këtij vendimi;
- ç) është një instrument investimesh kolektive i përjashtuar; ose
- d) është një trust deri në masën që administratori i besuar i trustit është një institucion financiar raportues dhe e raporton të gjithë informacionin që duhet raportuar në përputhje me nenin 4, me të gjitha llogaritë e raportueshme të trustit.

15. “Institucioni financiar raportues” ka të njëjtën kuptim me përkufizimin e “institucioni financiar raportues” sipas përcaktimeve të ligjit.

16. “Institucion kujdestarie”, një njësi ekonomike që mban, si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj, aktive financiare për llogari të të tjerëve. Njësia ekonomike mban aktive

financiare për llogari të tjerëve si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj, nëse të ardhurat bruto të njësisë ekonomike që u atribuohen mbajtjes së aktiveve financiare dhe shërbimeve financiare të lidhura me to janë të barabarta me ose i tejkalojnë 20% të të ardhurave bruto të njësisë ekonomike, në më pak se:

a) periudha trevjeçare që përfundon më 31 dhjetor përpara vitit në të cilin bëhet përcaktimi; ose

b) periudha gjatë së cilës njësia ekonomike ka ekzistuar.

17. “Instrument investimesh kolektive i përjashtuar”, një njësi ekonomike investimesh që rregullohet si një instrument investimesh kolektive, me kusht që të gjitha interesat në instrumentin e investimeve kolektive të mbahen nga ose nëpërmjet individëve ose njësisë ekonomike që nuk janë persona të raportueshëm, përveç NFE-së pasive me persona kontrollues të cilët janë persona të raportueshëm.

Njësia ekonomike e investimeve që rregullohet si një instrument investimesh kolektive nuk dështon të kualifikohet, sipas pikës 17 të këtij neni, si një instrument i investimeve kolektive i përjashtuar vetëm sepse instrumenti i investimeve kolektive i ka emetuar bartësit aksione fizike, me kusht që:

a) instrumenti i investimeve kolektive nuk ka emetuar dhe nuk emeton asnjë aksion fizik për bartësin pas datës 31 dhjetor 2018;

b) instrumenti i investimeve kolektive i tërheq të gjitha këto aksione menjëherë pas heqjes dorë;

c) instrumenti i investimeve kolektive kryen procedurat e vigjilencës së duhur të parashtruara në nenet 5 deri në 10 raporton çdo informacion që kërkohet të raportohet lidhur me këto aksione kur këto aksione paraqiten për riblerje ose për pagesa të tjera; dhe

ç) instrumenti i investimeve kolektive disponon politika dhe procedura për të garantuar se këto aksione riblihen ose mbahen rezervë sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, përpara datës 1 janar 2019.

18. “Interes në kapital”, në rastin e një partneriteti që është institucion financiar, është qoftë interesi në kapital ose interesi në përfitime nga partneriteti. Në rastin e një trusti që është institucion financiar, interesi në kapital konsiderohet se mbahet nga çdo person që trajtohet si krijuesi i trustit ose përfituesi i të gjithë ose i një pjese të trustit, ose çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin. Personi i raportueshëm do të trajtohet si përfitues i një trusti nëse ky person i raportueshëm ka të drejtën të marrë direkt ose indirekt (për shembull, përmes një përfaqësuesi të caktuar) një shpërndarje të detyrueshme ose mund të marrë, direkt ose indirekt, një shpërndarje diskrete nga trusti.

19. “Juridiksion i raportueshëm” do të thotë:

a) për qëllime të zbatimit të procedurave të vigjilencës së duhur të përshkruara në nenet 5 deri në 10, një juridiksion tjetër përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose Shqipërisë;

b) për qëllime të aplikimit të nenit 4, juridiksionii cili është identifikuar në shtojcën II bashkëlidhur këtij vendimi; dhe

c) juridiksion me të cilin Republika e Shqipërisë synon të shkëmbejë informacion mbi llogaritë financiare.

20. “Juridiksion pjesëmarrës”, një juridiksion që ka nënshkuar marrëveshjen shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare dhe i cili është identifikuar si i tillë në shtojcën I bashkëlidhur këtij vendimi.

21. “Kontrata e pensionit vjetor të grupit”, një kontratë pensioni vjetor që mbulon individë që janë të lidhur me një punëdhënës, shoqatë tregtare, sindikatë punëtore ose ndonjë shoqatë ose grup tjetër.

22. “Kontratë e sigurimit në vlerë në para të gatshme”, kontrata e sigurimeve (e ndryshme nga kontrata e risigurimit ndërmjet dy shoqërive të sigurimeve), që ka një vlerë në para të gatshme.

23. “Kontratë pensioni vjetor”, kontrata sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një periudhë kohore të përcaktuar plotësisht ose pjesërisht, duke iu referuar jetëgjatësisë së

një ose më shumë individëve. Termi, gjithashtu, përfshin kontratën që konsiderohet të jetë një kontratë pensioni vjetor, në përputhje me ligjet, rregulloret ose praktikat e juridiksionit në të cilin është lëshuar kontrata dhe sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një numër të caktuar vitesh.

24. “Kontratë sigurimi” është një kontratë (e ndryshme nga kontrata e pensionit vjetor), sipas së cilës emetuesi bie dakord të paguajë një shumë të caktuar menjëherë pas ndodhjes së një kontingjence specifike që përfshin vdekjen, sëmundshmërinë, aksidentin, detyrimin ose riskun e pronës.

25. “Kontratë sigurimi në vlerë në para të gatshme e grupit”, një “kontratë sigurimi në vlerë në para të gatshme” që siguron mbulim për individët që janë të lidhur me një punëdhënës, shoqatë tregtare, sindikatë punonjësish ose ndonjë shoqatë ose grup tjetër dhe qëtarifon një çmim për secilin anëtar të grupit (ose anëtar të një kategorie brenda grupit), që përcaktohet pa marrë parasysh karakteristikat individuale shëndetësore, të tjera nga mosha, gjinia dhe zakoni i pirjes së duhanit të anëtarit (ose klasës së anëtarëve) të grupit.

26. “Llogari depozite” përfshin çdo llogari tregtare, llogari rrjedhëse, llogari kursimesh, llogari me afat ose llogari që identifikohet përmes një certifikate depozite, certifikatë kursimesh, certifikatë investimesh, certifikatë borxhi ose instrumente të tjera të ngjashme që mbahen nga institucioni financiar në punën e zakonshme të aktivitetit bankar ose të ngjashëm me të. Llogaria e depozitës përfshin, gjithashtu, shumën e mbajtur nga shoqëria e sigurimeve sipas kontratës së investimeve të garantuara ose të marrëveshjes së ngjashme me të për të paguar ose për të kredituar interesat përkatës.

27. “Llogari e përjashtuar” është secila prej llogarive të mëposhtme:

a) Llogaria e pensionit të pleqërisë ose e pensionit që përmbush të gjitha kriteret vijuese:

i. llogaria është objekt rregullimi si llogari personale pensioni ose është pjesë e një skeme pensioni pleqërie të rregulluar dhe të regjistruar ose pensioni tjetër, e cila ofron përfitim në formë pensioni pleqërie ose pensioni tjetër (duke përfshirë pensionin për invaliditetin ose pensionin familjar);

ii. llogaria është e favorizuar nga pikëpamja tatimore (d.m.th. kontributet në llogari që në një tjetër kontekst do të ishin objekt i tatimit zhvishen ose përjashtohen nga të ardhurat bruto të mbajtësit të llogarisë ose taten në nivele të reduktuara, ose tatimi mbi të ardhurat nga investimi nga llogaria shtyhet ose taten në nivele të reduktuara);

iii. lidhur me llogarinë kërkohet raportim i informacionit pranë autoriteteve tatimore;

iv. tërheqjet kushtëzohen me arritjen e moshës së specifikuar të pensionit të pleqërisë, invaliditetin ose vdekjen, ose, në të kundërt, do të zbatohen penalitete mbi tërheqjet e kryera përpara këtyre ngjarjeve të specifikuara; dhe

v. kontributet vjetore nuk duhet t'i kalojnë 50000 USD ose limiti maksimal i kontributeve në llogari gjatë të gjithë jetës nuk duhet t'i kalojë 1000000 USD (një milion dollarë) dhe në çdo rast do të zbatohen rregullat e parashtruara në pikën 3, të nenit 10, për totalizimin e llogarisë dhe konvertimin e monedhës. Llogaria financiare që për më tepër përmbush kërkesën e parashikuar në nënparagrafët “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “v”, të shkronjës “a”, të pikës 27, të këtij neni, nuk do të dështojë në përmbushjen e kësaj kërkesë, vetëm sepse kjo llogari financiare mund të marrë aktive ose fonde të transferuara nga një ose më shumë llogari financiare që përmbushin kërkesat e shkronjave “a” ose “b”, të pikës 27, të këtij neni, apo nga një ose më shumë fonde pensioni ose pleqërie që përmbushin kërkesat e secilës prej pikave 9, 7, 4 të këtij neni.

b) Llogaria që përmbush kërkesat e mëposhtme:

i. llogaria është objekt i rregulloreve si një instrument investimesh për qëllime të ndryshme nga pensioni dhe tregtohet rregullisht në një treg të konsoliduar letrashme vlerë ose llogaria është objekt i rregulloreve si instrument kursimesh, për qëllime të ndryshme nga pensioni;

ii. llogaria është e favorizuar nga pikëpamja tatimore (d.m.th., kontributet në llogari, që në një tjetër kontekst do të ishin objekt i tatimit zhvishen ose përjashtohen nga të ardhurat bruto të mbajtësit të llogarisë ose taten në nivele të reduktuara, ose tatimi mbi të ardhurat nga investimi nga llogaria shtyhet ose taten në nivele të reduktuara);

iii. tërheqjet kushtëzohen nga përmbushja e kriterëve specifike të lidhura me qëllimin e llogarisë së investimeve ose të kursimeve (për shembull, dhënia e përfitimeve shëndetësore ose arsimore) ose do të zbatohen penalitete për tërheqjet e kryera përpara përmbushjes së këtyre kriterëve; dhe

iv. kontributet vjetore nuk e kalojnë limitin prej 50 000 USD, duke zbatuar rregullat e parashtruara në pikën 3, të nenit 10, për totalizimin e llogarisë dhe konvertimin e monedhës.

Llogaria financiare, që për më tepër përmbush kërkesat e nënparagrafit “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 27, të këtij neni, nuk do të dështojë në përmbushjen e kësaj kërkesë vetëm sepse kjo llogari financiare mund të marrë aktive ose fonde të transferuara nga një ose më shumë llogari financiare, që përmbushin kërkesat e shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 27, të këtij neni, nga një ose më shumë fonde pensioni pleqërie ose pensioni, që përmbushin kërkesat e secilës prej pikave 9, 7, 4 të këtij neni.

c) Kontrata e sigurimit të jetës me një periudhë mbulimi, që do të mbarojë përpara se individi i siguruar të arrijë moshën 90 vjeç, me kusht që kontrata të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

i. primet periodike, që nuk ulen me kalimin e kohës, paguhet të paktën çdo vit gjatë periudhës që kontrata është ekzistuese ose deri kur i siguruari të arrijë moshën 90 vjeç, cilado periudhë që është më e shkurtër;

ii. kontrata nuk ka një vlerë kontrate tek e cila çdo person mund të ketë akses (përmes tërheqjes, huas ose ndryshe) pa e zgjidhur kontratën;

iii. shuma (e ndryshme nga pensioni familjar) që paguhet pas anulimit ose zgjidhjes së kontratës nuk mund të tejkalojë primet e përgjithshme që janë paguar për kontratën, minus shumën e shpenzimeve në rast vdekjeje, sëmundjeje, dhe tarifave të shpenzimeve (pavarësisht nëse janë vendosur realisht ose jo) për periudhën ose periudhat e ekzistencës së kontratës dhe çdo shumë të paguar përpara anulimit ose zgjidhjes së kontratës; dhe

iv. kontrata nuk mbahet nga personi tek i cili transferohet për vlerën e saj.

ç) Llogaria e cila mbahet vetëm nga një titull pronësie, nëse dokumentacioni për këtë llogari përfshin një kopje të testamentit të personit të vdekur ose certifikatën e vdekjes.

d) Llogaria e krijuar lidhur me secilën nga pikat vijuese:

i. një urdhër ose vendim gjykate;

ii. një shitje, shkëmbim ose qiradhënie/marrje të pasurisë së paluajtshme ose personale, me kusht që llogaria të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- llogaria financohet vetëm nga depozitimi i një page në llogari, si garanci ekzekutimi në sasinë e mjaftueshme për të garantuar detyrimin e lidhur direkt me transaksionin ose nga pagesa të ngjashme, ose financohet nga aktivet financiare të depozituara në llogari, lidhur me shitjen, shkëmbimin ose qiramarrjen/dhënie të pasurisë;

- llogaria krijohet dhe përdoret vetëm për të garantuar detyrimin e blerësit për të paguar çmimin e blerjes, të shitësit për të paguar çdo detyrim kontingjence ose të qiramarrësit apo qiradhënësit për të paguar për çdo dëm lidhur me pasurinë e marrë/dhënë me qira, siç është rënë dakord në kontratë;

- aktivet e llogarisë, duke përfshirë edhe të ardhurat e fituara prej saj, do të paguhet ose shpërndahet në përfitim të blerësit, shitësit, qiramarrësit ose qiradhënësit (duke përfshirë edhe përmbushjen e detyrimit të këtij personi) në momentin kur pasuria shitet, shkëmbehet ose hiqet dorë prej saj apo kur zgjidhet kontrata e qirasë;

- llogaria nuk është një llogari marzh apo e ngjashmeme të, e krijuar për shitjen ose shkëmbimin e aktivitetit financiar; dhe

- llogaria nuk lidhet me ndonjë llogari të përshkruar në shkronjën “dh”, të pikës 27, të këtij neni;

iii. detyrimi i institucionit financiar që jep huan e garantuar nga pasuria e paluajtshme për të hequr mënjane një pjesë të pagesës vetëm për shlyerjen e tatimeve ose të siguracioneve të lidhura me pasurinë e paluajtshme në një moment tjetër;

iv. detyrimi i institucionit financiar vetëm për të lehtësuar shlyerjen e tatimeve në një moment tjetër.

dh) Llogaria e depozitës që përmbush kërkesat e mëposhtme:

i. llogaria ekziston vetëm sepse klienti kryen një pagesë përtej balancës së caktuar, lidhur me një kartë krediti ose instrumente të tjera kredie të rinovueshme dhe mbipagesa nuk ikthehet menjëherë klientit; dhe

ii. duke filluar në datën ose përpara datës 1 korrik 2019, institucioni financiar zbaton politika dhe procedura, qoftë për ta penguar klientin që të kryejë mbipagesa, të cilat i tejkalojnë 50 000 USD ose për të garantuar që çdo mbipagesë e klientit, që e tejkalon vlerën 50 000 USD, i rimburohet klientit brenda 60 ditëve dhe, në secilin rast zbatohen rregullat e parashtruara në pikën 3, të nenit 10, për konvertimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk u referohet balancave të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara, por përfshijnë balancat e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.

28. “Llogari e raportueshme”, llogaria që mbahet nga një ose më shumë persona të raportueshëm ose nga një NFE pasive me një ose më shumë persona kontrollues që është person i raportueshëm, me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në bazë të procedurave të vigjilencës së duhur, të përshkruara në nenet 5 dhe 6.

29. “Llogari e re”, një llogari financiare e mbajtur nga një institucion financiar raportues, të hapur më ose pas 1 janarit 2019.

30. “Llogari e re e njësisë ekonomike”, një llogari e re e mbajtur nga një ose më shumë njësi ekonomike.

31. “Llogari e re individuale”, një llogari e re e mbajtur nga një ose më shumë individë.

32. “Llogari financiare”, llogaria që mbahet nga një institucion financiar dhe përfshin llogarinë e depozitës, llogarinë e kujdestarisë dhe:

a) Në rastin e një njësie ekonomike investimesh, çdo interes në kapital ose borxh në institucionin financiar. Pavarësisht nga sa më lart, termi “llogari financiare” nuk përfshin asnjë interes në kapital ose borxh në një njësi ekonomike që është njësi ekonomike investimesh, vetëm sepse ajo:

i. jep këshilla investimi dhe vepron për llogari të; ose

ii. menaxhon portofolin e dhe vepron për llogari të klientit, për qëllime të investimit, menaxhimit ose administrimit të aktiveve financiare të depozituara në emrin e klientit te një institucion financiar, i ndryshëm nga kjo njësi ekonomike;

b) Në rastin e një institucioni financiar që nuk është përshkruar në shkronjën “a”, të pikës 32, të këtij neni, çdo interes në kapital ose borxh në institucionin financiar, nëse lloji i interesit është përcaktuar me qëllim shmangien e raportimit në pajtim me nenin 4; dhe

c) Çdo kontratë sigurimi në vlerë në para të gatshme dhe çdo kontratë pensioni vjetor që lëshohet ose mbahet nga institucioni financiar, e ndryshme nga pagesat vjetore për sigurimin e jetës, që nuk janë të lidhura me investimet, nuk janë të transferueshme dhe të menjëhershme, të cilat i jepen një individit dhe që i jep vlerë monetare pensionit ose pensionit të invaliditetit, i cili jepet në një llogari që është llogari e përjashtuar.

Termi “llogari financiare” nuk përfshin asnjë llogari e cila është një llogari e përjashtuar.

33. “Llogari individuale paraekzistuese”, një llogari paraekzistuese të mbajtur nga një apo disa individë.

34. “Llogari kujdestarie”, një llogari (e ndryshme nga kontratat e sigurimeve ose kontratat e pensionit vjetor), që mban një ose më shumë aktive financiare në përfitim të një personi tjetër.

35. “Llogari me vlerë më të ulët”, një llogari individuale paraekzistuese me një balancë apo vlerë të përgjithshme, në datën 31 dhjetor 2018, që nuk tejkalon shumën 1000000 USD (një milion dollarë).

36. “Llogari me vlerë të madhe”, llogaria paraekzistuese individuale me një balancë ose vlerë të përgjithshme që e kalon nivelin 1000000 USD (një milion dollarë), në datën 31 dhjetor 2018 ose në datën 31 dhjetor të çdo viti pasues.

37. “Llogari paraekzistuese” nënkupton:

a) Një llogari financiare të mbajtur nga një institucion financiar raportues deri më 31 dhjetor 2018;

b) Çdo llogari financiare të mbajtesit të llogarisë pavarësisht nga data kur kjo llogari financiare është hapur, nëse:

i. mbajtësi i llogarisë, gjithashtu, mban në institucionin financiar raportues (ose në një njësi ekonomike tjetër të lidhur, që i përket të njëjtit juridiksion si institucioni financiar raportues), një llogari financiare që është një llogari paraekzistuese, sipas nënparagrafit “a”, të pikës 37 të këtij neni;

ii. institucioni financiar raportues (dhe, sipas rastit, organi përkatësi të njëjtit juridiksion, ashtu si edhe institucioni financiar raportues), trajton të dyja llogaritë financiare të lartpërmendura dhe çdo llogari tjetër financiare të mbajtesit të llogarisë që trajtohet si llogari paraekzistuese në pajtim me këtë paragraf, si një llogari të vetme financiare në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të nenit 10, dhe për qëllim të përcaktimit të balancës ose të vlerës së secilës prej llogarive financiare gjatë aplikimit të pragut;

iii. në rastet enjë llogarie financiare, që është subjekt i pastrimit të parave dhe i nje procedurat e klientit (PPP/NJKT), institucioni financiar raportues është i lejuar të plotësojë procedurat PPP/NJKT për llogarinë financiare, duke u mbështetur në procedurat e PPP-së/NJKT-sëtë kryera për llogarinë paraekzistuese, sipas shkronjës “a”, të pikës 37, të këtij neni; dhe

iv. hapja e llogarisë financiare nuk kërkon dhënien e informatave të reja, shtesë ose të ndryshuara të klientëve nga mbajtësi i llogarisë, përveçse për qëllimet e këtij vendimi.

38. “Llogari paraekzistuese e njësisë ekonomike”, një llogari paraekzistuese e mbajtur nga një ose më shumë njësi ekonomike.

39. “Mbajtës i llogarisë”, personi i listuar ose i identifikuar si mbajtësi i llogarisë financiare nga institucioni financiar që mban llogarinë. Personi, i ndryshëm nga institucioni financiar, që mban një llogari financiare në përfitim të ose për llogari të një personi tjetër si agent, kujdestar, i emëruar, nënshkrues, këshilltar investimesh ose ndërmjetës, nuk trajtohet si person që e mban llogarinë për qëllime të këtij vendimi dhe personi tjetër trajtohet si personi që mban llogarinë. Në rastin e një kontrate sigurimi në vlerë në para të gatshme ose kontrate pensioni vjetor, mbajtësi i llogarisë është çdo person i cili ka të drejtë të ketë akses në vlerën në para të gatshme ose të ndryshojë përfituesin e kontratës. Nëse asnjë person nuk mund të ketë akses në vlerën në para të gatshme ose të ndryshojë përfituesin, mbajtësi i llogarisë është çdo person i emëruar si pronar në kontratë dhe çdo person mbi të cilin bie e drejta e pagesës sipas kushteve të kontratës. Menjëherë pas maturimit të kontratës së sigurimit në vlerë në para të gatshme ose kontratës së pensionit vjetor, çdo person që ka të drejtë të marrë pagesë, sipas kontratës, do të trajtohet si mbajtës llogarie.

40. “NFE”, çdo njësi ekonomike që nuk është një institucion financiar (NJEJIF).

41. “NFE aktive”, çdo NFE që përmbush secilin prej kriterëve të mëposhtme:

a) më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së për vitin kalendarik paraardhës ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi janë të ardhura pasive dhe më pak se 50% e aktiveve të mbajtura nga NFE-ja gjatë vitit kalendarik paraardhës ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi janë aktive që prodhojnë ose mbahen për prodhimin e të ardhurave pasive;

b) aksionet e NFE-së tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë ose NFE-ja është njësi e lidhur me një njësi ekonomike, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë;

c) NFE-ja është një organ qeveritar, një organizatë ndërkombëtare, një Bankë Qendrore ose një njësi ekonomike e zotëruar plotësisht nga një ose më shumë prej të lartpërmendurave;

ç) në thelb, të gjitha aktivitetet e NFE-së konsistojnë në mbajtjen (plotësisht ose pjesërisht) të aksioneve të qarkullueshme të, ose në ofrimin e financimit dhe të shërbimeve për një ose më shumë filiale që angazhohen në tregti ose biznese të ndryshme nga biznesi i institucionit financiar, por njësia ekonomike nuk kualifikohet për këtë status, nëse njësia ekonomike funksionon (ose pretendon se funksionon) si një fond investimi, i tillë si fond privat me kapital neto, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë ose çdo instrument

investimi, qëllimi i të cilit është blerja ose financimi i shoqërive dhe më pas mbajtja e interesave në ato shoqëri si aktive kapitali për qëllime investimi;

d) NFE-ja ende nuk po operon një biznes dhe nuk ka asnjë historik të mëparshëm operimi, por po investon kapital në aktive me synimin për të operuar një biznes të ndryshëm nga ai i institucionit financiar, me kusht që NFE-ja nuk kualifikohet për këtë përjashtim pas datës e cila është 24 muaj pas datës së organizimit fillestar të NFE-së;

dh) NFE-ja nuk ka qenë një institucion financiar në pesë vjetët e fundit dhe është në procesin e likuidimit të aktiveve të saj, ose po riorganizohet me qëllim vijimin ose rifillimin e operacioneve në një biznes të ndryshëm nga ai i institucionit financiar;

e) NFE-ja angazhohet kryesisht në financimin dhe në mbrojtjen e transaksioneve me ose për njësitë ekonomike të lidhura që nuk janë institucione financiare dhe nuk i ofron shërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë njësie ekonomike që nuk është njësi ekonomike e lidhur, me kusht që grupi i çdo njësie të tillë ekonomike të lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i institucionit financiar; ose

ë) NFE-ja përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:

i. ajo është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës vetëm për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, artistike, kulturore, atletike ose arsimore, ose është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës dhe është një organizatë profesionale, ligë biznesi, dhomë tregtie, organizatë pune, organizatë bujqësore ose e hortikulturës, ligë civile ose një organizatë e cila funksionon ekskluzivisht për promovimin e mirëqenies sociale;

ii. ajo është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat në juridiksionin e saj të rezidencës;

iii. ajo nuk ka aksionarë ose anëtarë të cilët kanë një interes pronësor ose përfitimi në të ardhurat ose aktivet e saj;

iv. ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së nuk e lejojnë shpërndarjen ose kalimin e të ardhurave apo aktiveve në përfitim të personave privatë ose të një njësie jobamirëse, përveçse në pajtim me kryerjen e aktiviteteve të bamirësisë të NFE-së ose si pagesë e një kompensimi të arsyeshëm për shërbimet e ofruara, ose si pagesë që përfaqëson vlerën e drejtë në treg të pasurisë që ka blerë NFE; dhe

v. ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së kërkojnë që pas likuidimit ose shpërbërjes së NFE-së, të gjitha aktivet e saj t'i shpërndahen një organi qeveritar ose organizate tjetër jofitimprurëse ose t'i rikthehen qeverisë së juridiksionit të rezidencës së NFE-së apo çdo nënndarjeje politike të saj.

42. “NFE pasive”, çdo NFE që nuk është NFE aktive ose njësi ekonomike e përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 10, të këtij neni, që nuk është një institucion financiar i juridiksionit pjesëmarrës.

43. “Njësi ekonomike”, personi juridik ose struktura juridike, si: korporata, partneriteti, trusti ose fondacioni.

44. Njësi ekonomike është një “njësi ekonomike e lidhur” e një njësie tjetër, nëse:

a) secila prej njësive kontrollon tjetrën;

b) të dyja njësitë ekonomike janë nën një menaxhim të përbashkët; ose

c) të dyja njësitë ekonomike janë fonde investimi, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 10, të këtij neni, janë nën një menaxhim të përbashkët dhe një menaxhim i tillë përmbush detyrimet e vigjilencës sëduhur të fondeve të tilla të investimit. Për këtë qëllim, kontrolli përfshin pronësinë direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votave dhe vlerës në një njësi ekonomike.

45. “Numër identifikues i tatimpaguesit (TIN)”, numri identifikues i tatimpaguesit (NIT) ose ekuivalenti i tij funksional. Për qëllime tatimore, për personat e tatuashëm TIN do të nënkuptojë NIPT-in (numri i identifikimit të personit të tatuashëm), lëshuar sipas legjislacionit shqiptar. Si numër identifikimi për qëllime tatimore, për tatimpaguesin që është individ, shërben numri personal i identifikimit, i marrë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

46. “Organ qeveritar”, qeveria e një juridiksioni, çdo nënndarje politike e një juridiksioni (që për të shmangur dyshimet përfshin shtetin, provincën, qarkun ose bashkinë) ose çdo agjenci ose organizëm që i përket plotësisht juridiksionit ose ndonjë apo më shumë prej të

lartpërmendurave (ku secila prej tyre përbën një “organ qeveritar”). Kjo kategori përbëhet nga pjesët integrale, njësitë e kontrolluara dhe nënndarjet politike të një juridiksioni.

a) “Pjesë integrale” e një juridiksioni është çdo person, organizatë, agjenci, byro, fond, organizëm ose organ tjetër, pavarësisht emërimit, që përbën një autoritet qeverisës së një juridiksioni. Fitimet neto të autoritetit qeverisës duhet të kreditohen në llogarinë e tij ose në llogari të tjera të juridiksionit, ku asnjë pjesë e tyre nuk do të shkojë në përfitim të asnjë personi privat. Pjesa integrale nuk përfshin asnjë individ që mund të jetë sovran, zyrtar ose administrator që vepron në cilësinë private ose personale.

b) Një njësi e kontrolluar është njësi që është e ndarë në formë nga juridiksioni apo që ndryshe përbën një njësi juridike të veçantë, me kusht që:

i. njësi të jetë plotësisht e zotëruar ose e kontrolluar nga një ose më shumë organe qeveritare, në mënyrë direkte ose nëpërmjet një apo më shumë njësive të kontrolluara;

ii. fitimet neto të njësisë kreditohen në llogarinë e saj ose në llogaritë e një ose më shumë organeve qeveritare, ku asnjë pjesë e tyre nuk do të shkojë në përfitim të asnjë personi privat; dhe

iii. në momentin e shpërbërjes, aktivet e njësisë i atribuohen një ose më shumë organeve qeveritare.

c) Të ardhurat nuk shkojnë në përfitim të personave privatë, nëse këta persona janë përfituesit e synuar të një programi qeveritar dhe veprimtaritë e programit kryhen për publikun e gjerë për mirëqenien e përbashkët ose lidhen me administrimin e disa fazave të qeverisë. Megjithatë, pavarësisht nga sa më lart, të ardhurat shkojnë në përfitim të personave privatë, nëse të ardhurat vijnë si rezultat i përdorimit të një organi qeveritar për të kryer një aktivitet tregtar, si aktiviteti bankar tregtar që u ofron shërbime financiare personave privatë.

47. “Organizatë ndërkombëtare”, çdo organizatë ndërkombëtare ose agjenci apo organizëm i zotëruar plotësisht prej tyre. Kjo kategori përfshin çdo organizatë ndërqeveritare (duke përfshirë organizatat supranacionale):

a) që përbëhet kryesisht nga qeveritë;

b) që ka në fuqi një marrëveshje për selinë ose një marrëveshje të ngjashme në thelb me juridiksionin; dhe

c) të ardhurat e së cilës nuk shkojnë në përfitim të personave privatë.

48. “Person i juridiksionit të raportueshëm”, individ i ose njësi ekonomike që është rezident në një juridiksion të raportueshëm, në bazë të legjislacionit tatimor të këtij juridiksioni ose pasuria e trashëgimlënësit që ka qenë rezident i një juridiksioni të raportueshëm. Për këtë qëllim, njësi ekonomike, e tillë si partneriteti, partneriteti me përgjegjësi të kufizuara ose strukturat ligjore të ngjashme që nuk kanë rezidencë për qëllime tatimore, do të trajtohen si rezidentë në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi ose menaxhimi aktiv.

49. “Person i raportueshëm”, personi i juridiksionit të raportueshëm, i ndryshëm nga:

a) korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë;

b) çdo korporatë që është njësi ekonomike e lidhur me korporatën e përshkruar në shkronjën “a”;

c) organi qeveritar;

ç) organizata ndërkombëtare;

d) banka qendrore; ose

dh) institucioni financiar.

50. “Persona kontrollues”, personat fizikë që ushtrojnë kontroll mbi njësinë ekonomike. Në rastin e një trusti, ky term nënkupton krijuesin e trustit, administratorin e trustit, ruajtësin (nëse ka), përfituesin ose kategoritë e përfituesve dhe çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin dhe në rastin e një strukture ligjore të ndryshme nga trusti, ky term nënkupton personat në pozicione të barasvlershme ose të ngjashme. Termi “persona kontrollues” duhet të interpretohet në mënyrë të pajtueshme me rekomandimet e Task Forcës për Aksionin Financiar.

51. “Procedurat për PPP/NJKT”, procedurat e vigjilencës sëduhur për klientin e institucionit financiar raportues në bazë të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave ose të ngjashme me to, kundrejt të cilave ky institucion financiar raportues është objekt.

52. “Sistem i standardizuar i kodimit të industrisë”, një sistem kodimi i përdorur për klasifikimin e objekteve sipas llojit të biznesit për qëllime të ndryshme nga qëllimet tatimore.

53. “Shoqëri sigurimesh e specifikuar”, çdo njësi ekonomike që është një shoqëri sigurimesh (ose shoqëria kontrolluese (*holding*) e shoqërisë së sigurimeve), që lëshon ose është e detyruar të kryejë pagesa lidhur me kontratat e sigurimit në vlerë në para të gatshme ose kontratat e pensionit vjetor.

54. “Vlerë në para të gatshme”, sasia më e madhe e shumave vijuese:

a) shuma që mbajtësi i policës ka të drejtë të marrë menjëherë pas mbylljes vullnetare ose zgjidhjes së kontratës (e përcaktuar pa llogaritur zbritjen e mundshme në formë penalizimi për çdo mbyllje vullnetare ose hua mbi policën); dhe

b) shuma që mbajtësi i policës mund të marrë hua sipas kontratës ose lidhur me të. Pavarësisht nga sa më sipër, termi “vlerë në para të gatshme” nuk përfshin shumën që paguhet sipas kontratës së sigurimit:

i. vetëm për shkak të vdekjes së individit të siguruar sipas kontratës së sigurimit të jetës;

ii. në formën e përfitimit personal nga lëndimi ose sëmundja ose të përfitimeve të tjera që zhdëmtojnë humbjen ekonomike të pësuar, për shkak të ndodhisë së një ngjarjeje ndaj së cilës është siguruar;

iii. në formën e një rimbursimi të një primi të paguar më parë (minus kostot e shpenzimeve të sigurimeve, pavarësisht nëse vendosen apo jo), sipas kontratës së sigurimit (e ndryshme nga kontrata e sigurimit të jetës lidhur me një investim ose kontrata e pensionit vjetor), për shkak të anulimit ose të zgjidhjes së kontratës, uljes së rrezikut të ekspozimit gjatë periudhës së veprimit të kontratës ose si rezultat i korigjimit të njoftimit apo të gabimit të ngjashëm lidhur me primin e kontratës;

iv. në formën e dividendit të mbajtësit të policës (i ndryshëm nga dividendi në zgjidhjen e kontratës), me kusht që dividendi të lidhet me një kontratë sigurimi, sipas së cilës të vetmet përfitime të pagueshme janë të përshkruara në nënpragrafin “i”, të shkronjës “b”, të pikës 54të këtij neni; ose

v. në formën e kthimit të primit të parapaguar ose të depozitës së primit për kontratën e sigurimit për të cilën primi paguhet të paktën çdo vit, nëse shuma e primit të parapaguar ose e depozitës së primit nuk e kalon primin vijues vjetor që do të paguhet sipas kontratës.

KREU II

KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE E VIGJILENCËS SË DUHUR

Neni 4

Kërkesat e përgjithshme të raportimit

1. Sipas pikave 3 deri 5, të këtij neni, çdo institucion financiar raportues duhet të raportojë tek administrata tatimore informacionin e mëposhtëm, në lidhje me secilën llogari të raportueshme të këtij institucioni financiar raportues:

a) Emrin, adresën, juridiksionin/et e rezidencës, TIN-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individit) të secilit person të raportueshëm që është mbajtës i llogarisë dhe në rastin e çdonjësie ekonomike që është mbajtës i llogarisë dhe qëpas aplikimit të procedurës së vigjilencës së duhur në përputhje me nenet 8, 9, 10, është konstatuar se ka një ose më shumë persona drejtues që janë personatë raportueshëm) emrin, adresën, juridiksionin/et e rezidencës dhe TIN-in/et e njësisë ekonomike, si dhe emrin, adresën, juridiksionin/et e rezidencës, TIN-in/et dhe datën dhe vendin e lindjes së secilit person të raportueshëm;

b) Numrin e llogarisë (ose ekuivalentin në mungesë të një numri të llogarisë);

c) Emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të institucionit financiar raportues;

ç) Gjendjen e llogarisë ose vlerën (përfshirë, në rastin e kontratës së sigurimit në vlerë në para të gatshme ose kontratë pensioni vjetor, vlerën në para të gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare), duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;

d) Në rastin e një llogarie kujdestarie:

i. shuma totale bruto e interesit, shuma totale bruto e dividendëve dhe shuma totale bruto e të ardhurave të tjera të krijuara, në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast të paguar ose të kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik; dhe

ii. të ardhurat totale bruto nga shitja ose shlyerja e aktiveve financiare të paguara ose të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik, në lidhje me të cilën institucioni financiar raportues ka vepruar si kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose, ndryshe, si agjent për mbajtësin e llogarisë;

dh) Në rastin e një llogarie depozitë, shumën totale bruto të interesit të paguar ose të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik; dhe

e) Në rastin e ndonjë llogarie që nuk është e përshkruar në shkronjat “d” ose “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shuma totale bruto e paguar ose e kredituar për mbajtësin e llogarisë, lidhur me llogarinë gjatë vitit kalendarik, në lidhje me të cilën institucioni financiar raportues është debitor, përfshirë shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për mbajtësin e llogarisë gjatë vitit kalendarik.

2. Informacioni i raportuar duhet të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse. Informacioni i raportuar nga institucionet raportuese financiare duhet të dërgohet pranë administratës tatimore në skedarë të veçantë XML për çdo juridiksion (shtet) që ato do të raportojnë, sipas mënyrës dhe procedurave të parashikuara në shtojcën IV të këtij vendimi.

3. Pavarësisht nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni, në lidhje me secilën llogari të raportueshme që është një llogari paraekzistuese ose në lidhje me secilën llogari financiare që është hapur para se të bëhet një llogari e raportueshme, TIN-i ose data e lindjes nuk kërkohet të raportohet, nëse ky TIN ose data e lindjes nuk është në regjistrat e institucionit financiar raportues dhe nuk kërkohet të mblidhet nga ky institucion financiar raportues, sipas legjislacionit të brendshëm. Pavarësisht këtij parashikimi, një institucion financiar raportues duhet të bëjë përpjekje nga ana e tij për të marrë TIN-in dhe datën e lindjes, në lidhje me llogaritë paraekzistuese deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin këto llogari janë identifikuar si llogari të raportueshme.

4. Pavarësisht nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni, TIN-i nuk kërkohet të raportohet, nëse:

a) TIN-i nuk është lëshuar nga juridiksioni i raportueshëm përkatës; ose

b) legjislacioni i brendshëm i juridiksionit të raportueshëm përkatës nuk e kërkon mbledhjen e TIN-it të lëshuar nga ky juridiksion i raportueshëm.

5. Pavarësisht nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni, vendi i lindjes nuk kërkohet të raportohet, me përjashtim të rasteve kur institucioni financiar raportues i kërkohet ta sigurojë dhe të raportojë sipas legjislacionit të brendshëm dhe është i disponueshëm në bazën e të dhënave të kërkueshme në format elektronik, të ruajtura nga institucioni financiar raportues.

6. Çdo institucion financiar raportues duhet të raportojë tek administrata tatimore informacionin e përshkruar në pikën 1, në ose para datës 30 maj të vitit pasues të vitit kalendarik të cilit i përket informacioni.

7. Nëse një institucion financiar raportues zbaton procedurat e vigjilencës së duhur, të përshkruara në nenet 5 deri në 10, për një vit të caktuar kalendarik dhe asnjë llogari nuk identifikohet si një llogari e raportueshme, institucioni duhet të kthejë përgjigje sqaruese së institucioni nuk mban asnjë llogari të raportueshme në lidhje me atë llogari.

Neni 5

Kërkesat e përgjithshme të vigjilencës së duhur

1. Një institucion financiar raportues duhet të krijojë, të mirëmbajë dhe të dokumentojë procedurat e vigjilencës së duhur, të përcaktuara në nenet 5 deri në 10, të cilat shërbejnë për të identifikuar llogaritë e raportueshme që mbahen nga institucioni financiar raportues.

2. Një llogari trajtohet si një llogari e raportueshme që nga data kur ajo është identifikuar si e tillë, në përputhje me procedurat e vigjilencës së duhur, sipas neneve 5 deri në 10 dhe, përveçse kur parashikohet ndryshe, informacioni në lidhje me një llogari të raportueshme duhet të raportohet çdo vit në vitin kalendarik që pason vitin me të cilin lidhet informacioni.

3. Gjendja ose vlera e një llogarie përcaktohet duke filluar nga dita e fundit të vitit kalendarik.

4. Kur limiti i gjendjes ose i vlerës së një llogarie do të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit të një viti kalendarik, gjendja ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e periudhës së raportimit që përfundon me vitin kalendarik ose brenda atij viti kalendarik.

5. Një institucion financiar raportues mund të përdorë një ofrues të shërbimit për të përmbushur detyrimet e raportimit dhe të vigjilencës së duhur, të cilat i janë vendosur këtyre institucioneve financiare raportuese, por përmbushja e këtyre detyrimeve do të mbetet përgjegjësi e institucioneve financiare raportuese.

5.1 Ofruesi i shërbimit, ndërmjetësi apo çdo person tjetër, që hyn në një marrëveshje ose angazhohet në praktikë, që synon të shmangë apo të anashkalojë detyrimet që rrjedhin nga ky vendim, konsiderohet subjekt i këtyre detyrimeve pavarësisht marrëveshjes së lidhur apo angazhimit në këtë praktikë.

6. Një institucion financiar raportues mund të aplikojë:

a) procedurat e vigjilencës së duhur për llogaritë e reja për të gjitha llogaritë paraekzistuese ose në lidhje me çdo grup të identifikuar qartë të llogarive paraekzistuese dhe rregullat për llogaritë paraekzistuese vazhdojnë të aplikohen pavarësisht këtyre; dhe

b) procedurat e vigjilencës së duhur për llogaritë me vlerë të lartë tellogaritë me vlerë të ulët.

Neni 6

Vigjilenca e duhur për llogaritë paraekzistuese individuale

Në lidhje me llogaritë individuale paraekzistuese do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

1. Llogaritë me vlerë të ulët. Lidhur me llogaritë e me vlerë të ulët zbatohen procedurat vijuese:

a) Adresa e rezidencës. Nëse institucioni financiar raportues ka në regjistrat e tij një adresë aktuale të rezidencës për mbajtësin e llogarisë individuale, bazuar në evidencat shkresore, institucioni financiar raportues mund të trajtojë mbajtësin e llogarisë individuale si rezident për qëllime tatimore të atij juridiksioni në të cilin ndodhet adresa për të përcaktuar nëse ky mbajtës i llogarisë individuale është si një person i raportueshëm.

b) Kërkimi elektronik i të dhënave. Nëse institucioni financiar raportues nuk identifikon një adresë aktuale rezidence për mbajtësin e llogarisë individuale, bazuar në evidencat shkresore, siç përcaktohet më sipër në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, institucioni financiar raportues duhet të rishikojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga institucioni financiar raportues për secilin nga treguesit e mëposhtëm dhe të zbatojë shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, të pikës 1, të këtij neni:

i. identifikimin e mbajtësit të llogarisë si rezident i një juridiksioni të raportueshëm;

ii. adresa postare aktuale ose adresa e rezidencës (përfshirë kutinë postare) në një juridiksion të raportueshëm;

iii. një ose më shumë numra telefoni në një juridiksion të raportueshëm dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e institucionit financiar raportues;

iv. urdhërpagesat periodike (të ndryshme nga ato që lidhen me një llogari depozite) për transferimin e fondeve në një llogari të mbajtur në një juridiksion të raportueshëm;

v. prokura e përfaqësimit në fuqi momentalisht ose autorizimi i nënshkrimit dhënë një personi me adresën e një juridiksioni të raportueshëm; ose

vi.një udhëzim mbi “ruajtjen e postës” ose një adresë “nën vëmendjen e”, në një juridiksion të raportueshëm, nëse institucioni financiar raportues nuk disponon ndonjë adresë tjetër në dosjen e mbajtësit të llogarisë.

c) Nëse në kërkimin elektronik nuk konstatohet asnjë prej treguesve të renditur në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, atëherë nuk kërkohet ndonjë veprim vijues derisa të ketë një ndryshim të rrethanave që rezulton në një ose më shumë tregues të lidhur me llogarinë, ose llogaria bëhet një llogarime vlerë të lartë.

ç) Nëse ndonjë nga treguesit e parashikuar në nënndarjet “i” deri “v”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, është zbuluar në kërkimin elektronik ose nëse ka një ndryshim të rrethanave që rezulton në një ose më shumë tregues që lidhen me llogarinë, atëherë institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë mbajtësin e llogarisë si rezident për qëllime tatimore të secilit juridiksion të raportueshëm, për të cilin është identifikuar një tregues, përveçse kur zgjedh të zbatojë shkronjën “dh”, të pikës 1, të këtij neni, dhe një prej përjashtimeve të të cilin zbatohen në lidhje me atë llogari.

d) Nëse gjatë kërkimit elektronik të të dhënave zbulohet një udhëzim për “ruajtjen e postës” ose një adresë “nën vëmendje të” dhe nuk identifikohet asnjë adresë tjetër, dhe asnjë prej treguesve të tjerë të listuar në nënndarjen “i”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, për mbajtësin e llogarisë, institucioni financiar raportues duhet që, në rëndin më të përshtatshëm të rrethanat, të aplikojë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, ose të kërkojë nga mbajtësi i llogarisë një vetëdeklarim ose evidenca shkresore për të përcaktuar rezidencën/at e tij për qëllime tatimore. Nëse nga kërkimi manual nuk arrihet të përcaktohet një tregues dhe përpyekja për të marrë vetëdeklarimin ose evidencat shkresore nuk rezulton e suksesshme, institucioni financiar raportues duhet të raportojë llogarinë tek administrata tatimore si një llogari të padokumentuar.

dh) Pavarësisht gjetjes së treguesve, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, një institucioni financiar raportues nuk i kërkohet të trajtojë një mbajtës të llogarisë si rezident të një juridiksioni të raportueshëm, nëse:

i. informacioni i mbajtësit të llogarisë përmban një adresë postare ose rezidencë në juridiksionin e raportueshëm, një ose më shumë numra telefoni në juridiksionin e raportueshëm (dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e institucionit financiar raportues) ose urdhërpagesa periodike (në lidhje me llogari financiare të ndryshme nga llogaritë e depozitave) për të transferuar fonde në një llogari të mbajtur në një juridiksion të raportueshëm dhe institucioni financiar raportues merr ose ka rishikuar më parë dhe mban të dhëna, për:

- një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij mbajtësi llogarie që nuk e përfshin këtë juridiksion të raportueshëm;

- evidencat shkresore që përcaktojnë rezidencën e klientit të llogarisë, për qëllime tatimore, përveç këtij juridiksioni të raportueshëm;

ii. informacioni i mbajtësit të llogarisë përmban një prokurë përfaqësimi në fuqi ose autorizim nënshkrimi i dhënë një personi me adresë në juridiksionin e raportueshëm dhe institucioni financiar raportues merr ose ka rishikuar më parë dhe mban të dhëna, për:

- një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij mbajtësi llogarie, që nuk e përfshin këtë juridiksion të raportueshëm; dhe

- evidencat shkresore dokumente provuese që përcaktojnë rezidencën e klientit të llogarisë për qëllime tatimore, përveç këtij juridiksioni të raportueshëm.

2. Procedurat e përmirësura të rishikimit për llogaritë me vlerë të lartë. Lidhur me llogaritë me vlerë të lartë zbatohen procedurat vijuese të përmirësuar të rishikimit:

a) Kërkimi elektronik i të dhënave. Në lidhje me llogaritë me vlerë të lartë, institucioni financiar raportues duhet të rishikojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike të ruajtura nga institucioni financiar raportues për secilin prej treguesve të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni.

b) Kërkimi manual i të dhënave. Nëse të dhënat elektronike të institucionit financiar raportues përfshijnë informacionin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij neni, atëherë nuk kërkohet një kërkim i mëtejshëm manual. Nëse të dhënat e kërkuara në formëelektronike nuk i përfshijnë të gjitha këto informacione, atëherë, në lidhje me një llogari me vlerë të lartë, institucioni financiar raportues duhet, gjithashtu, qëtë rishikojë dosjen aktuale kryesore të klientit dhe, nëse nuk përfshihen në dosjen e tij, dokumentet e mëposhtme të lidhura me llogarinë dhe të marrë nga institucioni financiar raportues brenda pesë vjetëvetë fundit për secilin prej treguesve të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni:

- i.evidencat shkresore më të fundit të mbledhura në lidhje me llogarinë;
- ii.kontrata ose dokumentacionin e fundit për hapjen e llogarisë;
- iii.dokumentacionin më të fundit të marrë nga institucioni financiar raportues, në përputhje me politikat e procedurave (PPP/NJK) ose për qëllime të tjera rregullatore;
- iv.çdo prokurë përfaqësimi apo autorizim nënshkrimi në fuqi; dhe
- v. çdo urdhërpagesë periodike (të ndryshme nga ato lidhur me llogaritë e depozitave) për të transferuar fonde, aktualisht në fuqi.

c)Përjashtim deri në masën që bazat e të dhënave përmbajnë informacion të mjaftueshëm. Një institucion financiar raportues nuk është i detyruar të kryejë kërkimin manual të të dhënave, të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, për sa kohë informacioni i kërkueshëm në format elektronik i institucionit financiar raportues përfshin sa më poshtë:

- i.statusin e rezidencës së mbajtësit të llogarisë;
- ii.adresën e rezidencës së mbajtësit të llogarisë dhe adresën postare të mbajtësit të llogarisë që ndodhet aktualisht në dosjen e institucionit financiar raportues;
- iii. numrin/at e telefonit të mbajtësit të llogarisë që aktualisht figurojnë (nëse ka), në dosjen e institucionit financiar raportues;
- iv.në rastin e llogarive financiare, të ndryshme nga llogaritë e depozitës, nëse ka urdhërpagesa periodike për të transferuar fondet nga llogaria në një tjetër llogari (duke përfshirë llogarinë në një degë tjetër të institucionit financiar raportues ose në një tjetër institucion financiar);
- v.nëse ka një adresë aktuale “në vëmendje të” ose udhëzim për “ruajtje të postës” për mbajtësin e llogarisë; dhe
- vi. nëse ka ndonjë prokurë të posaçme ose autorizim nënshkrimi për llogarinë.

ç)Marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve mbi njohuri reale. Përveç kërkimit elektronik dhe manual të të dhënave të përshkruara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, institucioni financiar raportues duhet të trajtojë si llogari të raportueshme çdo llogari me vlerë të lartë, të caktuar për një menaxher të marrëdhënieve (përfshirë çdo llogari financiare që i shtohet llogarisë me vlerë të lartë), nëse menaxheri i marrëdhënieve ka dijenireale se kjo llogari përket një rezidenti për qëllime tatimore në një juridiksion të raportueshëm.

d)Efekti i gjetjes së treguesve:

i.nëse asnjë prej treguesve të renditur në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, nuk është konstatuar në rishikimin e përmirësuar të llogarive me vlerë të lartë, të përshkruar në pikën 2, dhe llogaria nuk identifikohet si e mbajtur nga një rezident, për qëllime tatimore në një juridiksion të raportueshëm, sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të këtij neni, atëherë nuk kërkohen veprime vijuese derisa të ketë një ndryshim të rrethanave të cilat rezultojnë në një ose më shumë tregues që lidhen me llogarinë;

ii.nëse ndonjë prej treguesve të renditur në nënndarjet “i” deri “vi”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, janë konstatuar në rishikimin e përmirësuar të llogarive me vlerë të lartë, të përshkruar në pikën 2, të këtij neni ose, nëse ka një ndryshim pasues të rrethanave që rezultojnë në një ose më shumë tregues që lidhen me llogarinë, atëherë institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë mbajtësin e llogarisë si rezident për qëllime tatimore të çdo juridiksioni të raportueshëm për të cilin identifikohet treguesi, përveçsekur ai zgjedh të zbatojë shkronjën “dh”, të pikës 1, të këtij neni, dhe një nga përjashtimet në atë shkronjë zbatohen për atë llogari;

iii. nëse një udhëzim për “ruajtjen e postës” ose një adresë “në vëmendje të” konstatohet në rishikimin e përmirësuar të llogarive me vlerë të lartë të përshkruar në pikën 3 të këtij neni dhe asnjë adresë tjetër ose asnjë prej treguesve të tjerë të listuar në nënndarjet “i” deri në “v”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, nuk identifikohen për mbajtësin e llogarisë, institucioni financiar raportues duhet të marrë nga mbajtësi i llogarisë një vetëdeklarim ose evidenca shkresore për të përcaktuar rezidencën/at për qëllime tatimore të mbajtësit të llogarisë. Nëse institucioni financiar raportues nuk mund të sigurojë një vetëdeklarim ose evidenca shkresore, ai duhet të raportojë llogarinë si një llogari të padokumentuar tek administrata tatimore.

dh) Nëse një llogari individuale paraekzistuese nuk është një llogari me vlerë të lartë duke filluar që nga data 31 dhjetor 2018, por bëhet një llogari me vlerë të lartë, duke filluar nga dita e fundit vitit kalendarik pasues, institucioni financiar raportues duhet të përfundojë procedurat e përmirësuar të rishikimit, përshkruar në pikën 3 të këtij neni, në lidhje me këtë llogari brenda vitit kalendarik, pas vitit në të cilin llogaria kalon në një llogari me vlerë të lartë. Nëse bazuar në këtë rishikim, kjo llogari identifikohet si një llogari e raportueshme, institucioni financiar raportues duhet të raportojë informacionin e kërkuar për këtë llogari në lidhje me vitin në të cilin është identifikuar si llogari e raportueshme dhe çdo vit në vitet në vijim, përveçse kur mbajtësi i llogarisë pushon së qeni një person i raportueshëm.

e) Pasi një institucion financiar raportues aplikon procedurat e përmirësuar të rishikimit, përshkruar në pikën 2, të këtij neni, për një llogari me vlerë të lartë, nuk i kërkohet të riaplikojë këto procedura, përveçse marrjes në pyetje të menaxherit të marrëdhënieve sipas shkronjës “ç”, të pikës 2 të këtij neni, për të njëjtën llogari me vlerë të lartë në vitet në vijim, me përjashtim të rasteve kur llogaria është e padokumentuar, raste në të cilat institucioni financiar raportues duhet t’i rizbatojë ato çdo vit derisa kjo llogari të pushojë së qeni e padokumentuar.

ë) Nëse ka një ndryshim të rrethanave, në lidhje me një llogari me vlerë të lartë që rezulton që nënjë ose më shumë tregues të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, që lidhen me llogarinë, atëherë institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një llogari të raportueshme, në lidhje me secilin juridiksion të raportueshëm për të cilin është identifikuar një tregues, përveçse kur ai zgjedh të zbatojë shkronjën “dh”, të pikës 1, të këtij neni, dhe një prej përjashtimeve në atë shkronjë zbatohet në lidhje me atë llogari.

f) Një institucion financiar raportues duhet të aplikojë procedurat për të garantuar që menaxheri i marrëdhënieve të identifikojë çdo ndryshim në rrethanat e një llogarie. Për shembull, nëse një menaxher i marrëdhënieve njoftohet se mbajtësi i llogarisë ka një adresë të re postare në një juridiksion të raportueshëm, institucioni financiar raportues kërkohet të trajtojë adresën e re si një ndryshim në rrethana dhe nëse ai zgjedh të zbatojë shkronjën “dh”, të pikës 1, të këtij neni, i kërkohet të marrë dokumentacionin e duhur nga klienti i llogarisë.

3. Rishikimi i llogarive individuale paraekzistuese me vlerë të lartë duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2019 dhe rishikimi i llogarive paraekzistuese me vlerë të ulët duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2020.

4. Çdo llogari individuale paraekzistuese, që është identifikuar si një llogari e raportueshme sipas këtij neni, duhet të trajtohet si një llogari e raportueshme në të gjitha vitet pasuese, përveçse kur mbajtësi i llogarisë pushon së qeni një person i raportueshëm.

Neni 7

Procedura e vigjilencës së duhur për llogaritë e reja individuale

Për qëllime të identifikimit të llogarive të raportueshme për llogaritë e reja individuale do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

1. Në lidhje me llogaritë e reja individuale, me hapjen e llogarisë, institucioni financiar raportues duhet të kërkojë nga mbajtësi i llogarisë një vetëdeklarim, që mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë dhe që i jep mundësi institucionit financiar raportues të përcaktojë rezidencën/at e mbajtësit të llogarisë, për qëllimet tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëdeklarimi të bazuar në informacionin e marrë nga

institucioni financiar raportues, në lidhje me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur në përputhje me procedurat PPP/NJKT. Një llogari nuk do të hapet nëse ky vetëdeklarim nuk është marrë.

2. Nëse vetëdeklarimi vërteton se mbajtësi i llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një juridiksion të raportueshëm, institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një llogari të raportueshme dhe vetëdeklarimi duhet të përfshijë, gjithashtu, TIN-in e mbajtësit të llogarisë (sipas pikës 4, të nenit 4) dhe datën e lindjes.

3. Nëse ka një ndryshim të rrethanave, në lidhje me një llogari të re individuale, për të cilën institucioni financiar raportues ka dijenie ose arsye për të pasur dijeni se vetëdeklarimi origjinal është i pasaktë ose jo i besueshëm, institucioni financiar raportues nuk mund të mbështetet në këtë vetëdeklarim dhe duhet të marrë, ose:

a) një vetëdeklarim të vlefshëm që përcakton rezidencën/at për qëllime tatimore të mbajtësit të llogarisë; ose

b) një shpjegim dhe dokument të arsyeshëm (sipas rastit) që mbështet vlefshmërinë e vetëdeklarimit fillestar (dhe të mbahet një kopje ose një shënim i këtij shpjegimi dhe dokumenti).

4. Një institucion financiar raportues duhet të sigurohet që çdo ndryshim në rrethana të identifikohet dhe për këtë të njoftohet çdo person që lëshon një vetëdeklarim, për detyrimin që ai ka për të njoftuar institucionin financiar raportues për ndryshimin e rrethanave.

Neni 8

Vigjilenca e duhur për llogaritë paraekzistuese të njësive ekonomike

1. Llogaritë e njësive ekonomike që nuk kërkohet të rishikohen, identifikohen ose raportohen. Në rast se institucioni financiar raportues nuk zgjedh ndryshe, qoftë përsa i përket të gjitha llogarive paraekzistuese të njësive ekonomike ose, veçmas, në lidhje me çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive, një llogari paraekzistuese e njësive ekonomike me njëtotal llogarie ose vlerë që nuk tejkalon shumën 250000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga data 31 dhjetor 2018 nuk kërkohet të rishikohet, identifikohet ose raportohet si një llogari e raportueshme derisa balanca ose vlera totale e kësaj llogarie të tejkalojë këtë shumë, duke filluar nga dita e fundit e çdo viti kalendarik pasues.

2. Llogaritë e njësive ekonomike që i nënshtrohen rishikimit. Një llogari paraekzistuese e njësive ekonomike, që ka një balancë ose vlerë totale të llogarisë që tejkalon shumën 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga data 31 dhjetor 2018 dhe një llogari paraekzistuese e njësive ekonomike që nuk tejkalon 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga data 31 dhjetor 2018, por balanca ose vlera totale e llogarisë tejkalon 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga dita e fundit e çdo viti kalendarik pasues, duhet të rishikohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni.

3. Rishikimi i procedurave për identifikimin e llogarive të njësive ekonomike për të cilat kërkohet raportimi. Për llogaritë paraekzistuese të njësive ekonomike të përshkruara në pikën 2 të këtij neni, një institucion financiar raportues duhet të zbatojë procedurat e mëposhtme të rishikimit:

a) Të përcaktohet rezidenca e njësive ekonomike, si më poshtë vijon:

i. të rishikohet informacioni i mbajtur për qëllime rregullatore ose përmarrëdhëniet me klientin (përfshirë informacionin e mbledhur në përputhje me procedurat PPP/NJKT), për të përcaktuar rezidencën e mbajtësit të llogarisë për qëllime tatimore, me qëllim verifikimin nëse rezidenca e mbajtësit të llogarisë përfshin një adresë korporate ose organizate, ose një adresë në një juridiksion të raportueshëm;

ii. nëse informacioni tregon që mbajtësi i llogarisë është një person i raportueshëm, institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një llogari të raportueshme, përveçse kur merr një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë ose përcakton në

mënyrë të arsyeshme bazuar në informacionin që ka në dispozicion apo e disponon publikisht sembjatësi i llogarisë nuk është një person i raportueshëm.

b) Të përcaktohet rezidenca e personave që drejtojnë një njësi ekonomike jofinanciare pasive.

Në lidhje me mbajtësin e llogarisë së një llogarie paraekzistuese të njësisë ekonomike (përfshirë një njësi ekonomike që është një person i raportueshëm), institucioni financiar raportues duhet të përcaktojë nëse mbajtësi i llogarisë është njësi ekonomike jofinanciare pasive me një ose më shumë persona kontrollues dhe të përcaktojë rezidencën e këtyre personave kontrollues. Nëse ndonjë prej personave kontrollues të një njësie ekonomike jofinanciare pasive është një person i raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si një llogari e raportueshme. Gjatë këtyre përcaktimeve, institucioni financiar raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënndarjet “i” deri në “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij neni, sipas rendit më të përshtatshëm në përputhje me rrethanat:

i. të përcaktohet nëse mbajtësi i llogarisë është një njësi ekonomike jofinanciare pasive. Për qëllime të përcaktimit nëse mbajtësi i llogarisë është një njësi jofinanciare pasive, institucioni financiar raportues duhet të marrë një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse kurka informacion rreth tij apo e disponon publikisht, në bazë të të cilit mundet në mënyrë të arsyeshme të përcaktojë që mbajtësi i llogarisë është një njësi ekonomike jofinanciare aktive ose një institucion financiar, përveç një fondi investimesh, i përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 6, të nenit 3, që nuk është një institucion financiar i juridiksionit pjesëmarrës;

ii. të përcaktohen personat kontrollues të mbajtësit të llogarisë. Për qëllime të përcaktimit të personave kontrollues të një mbajtësi të llogarisë, një institucion financiar raportues mund të mbështetet në informacionet e mbledhura dhe të mbajtura në përputhje me procedurat PPP/NJKT.

c) Të përcaktohet rezidenca e një personi kontrollues të një NFE-je pasive. Për qëllime të përcaktimit të rezidencës së një personi kontrollues të një NFE-je pasive, një institucion financiar raportues mund të mbështetet, në:

i. informacione të mbledhura dhe të mbajtura në përputhje me procedurat PPP/NJKT në rastin e një llogarie paraekzistuese të një njësie ekonomike të mbajtur nga një ose më shumë NFE, me një balancë total llogarishose vlerë që nuk tejkalon 1 000 000 USD (një milion dollarë); ose

ii. një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë ose personit kontrollues, sipas juridiksionit/ve në të cilin personi kontrollues është rezident për qëllime tatimore. Nëse nuk sigurohet vetëdeklarim, institucioni financiar raportues do të përcaktojë rezidencën/at, duke aplikuar procedurat e përshkruara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 6. Nëse institucioni financiar raportues nuk ka asnjë tregues të dhënave të tij, atëherë nuk do të kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm, derisa të ketë një ndryshim të rrethanave që rezulton në një ose më shumë tregues në lidhje me personin kontrollues që lidhet me llogarinë.

4. Afati i rishikimit dhe procedurat shtesë që zbatohen për llogaritë paraekzistuese të njësisë ekonomike.

a) Rishikimi i llogarive paraekzistuese të njësisë ekonomike me një balancë total llogarieose vlerë që tejkalon shumë 250 000 dollarë (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga data 31 dhjetor 2018, duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2020.

b) Rishikimi i llogarive paraekzistuese të njësisë ekonomike me një balancë total llogarie ose vlerë që nuk tejkalon shumë 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga data 31 dhjetor 2018, por që tejkalon shumë 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë), duke filluar nga dita e fundit e vitit kalendarik pasues, duhet të përfundojë brenda vitit kalendarik pas vitit në të cilin balancaose vlera totale e llogarisë tejkalon shumë 250 000 USD (dyqind e pesëdhjetëmijë dollarë).

c) Nëse ka një ndryshim të rrethanave në lidhje me një llogari paraekzistuese të njësisë ekonomike, për të cilën institucioni financiar raportues ka dijeni ose në bazë të rrethanave duhej të kishte dijeni se vetëdeklarimiose dokumentacioni mbështetës është i pasaktë ose jo i

besueshëm, institucioni financiar raportues duhet të ripërcaktojë statusin e llogarisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni.

Neni 9

Vigjilenca e duhur për llogaritë e reja të njësive ekonomike

Për identifikimin e llogarive të reja të njësive ekonomike, një institucion financiar raportues duhet të zbatojë procedurat e mëposhtme të rishikimit:

1. Përcakton rezidencën e njësisë ekonomike, sipas procedurës së mëposhtme:

a) Marrja e një vetëdeklarimi, që mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, që lejon institucionin financiar raportues të përcaktojë rezidencën/at e mbajtësit të llogarisë për qëllime tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëdeklarimi, bazuar në informacionin e marrë nga institucioni financiar raportues, në lidhje me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur në përputhje me procedurat për PPP/NJKT. Nëse njësia ekonomike vërteton se nuk ka rezidencë për qëllime tatimore, institucioni financiar raportues mund të mbështetet në adresën e selisë kryesore të njësisë ekonomike për të përcaktuar rezidencën e mbajtësit të llogarisë. Llogaria nuk hapet nëse nuk është marrë vetëdeklarimi.

b) Nëse vetëdeklarimi tregon se mbajtësi i llogarisë është rezident në një juridiksion të raportueshëm, institucioni financiar raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një llogari të raportueshme, përveçse kur përcakton në mënyrë të arsyeshme, bazuar në informacionin që ka ose që është publikisht i disponueshëm, se mbajtësi i llogarisë nuk është një person i raportueshëm në lidhje me këtë juridiksion të raportueshëm.

2. Përcakton rezidencën e personave kontrollues të një NFE-je pasive. Në lidhje me mbajtësin e llogarisë së një llogarie të retë një njësie ekonomike (përfshirë një njësi ekonomike që është një person i raportueshëm), institucioni financiar raportues duhet të përcaktojë nëse mbajtësi i llogarisë është NFE pasive me një ose më shumë persona kontrollues dhe të përcaktojë rezidencën e këtyre personave të raportueshëm. Nëse ndonjë prej personave kontrollues të një NFE-je pasive është një person i raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si një llogari e raportueshme. Kur bën këto përcaktime, institucioni financiar raportues duhet të ndjekë udhëzimet në shkronjat “a” deri “c”, të pikës 2, të këtij neni në rëndin më të përshtatshëm, sipas rrethanave.

a) Përcakton nëse mbajtësi i llogarisë është një NFE pasive. Për qëllime të përcaktimit nëse mbajtësi i llogarisë është një NFE pasive, institucioni financiar raportues duhet të mbështetet në një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë për të vendosur mbi statusin e tij, përveçse kur ai ka informacione rreth tij ose ka informacion të disponueshëm publikisht, në bazë të të cilit mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që mbajtësi i llogarisë është një njësi ekonomike jofinanciare aktive ose një institucion financiar, përveçse një fond investimesh të përshkruar në shkronjën “b”, të pikës 6, të nenit 3, që nuk është një institucion financiar i një juridiksioni pjesëmarrës.

b) Përcaktimi i personave kontrollues të një mbajtësi llogarie. Për qëllime të përcaktimit të personave kontrollues të një mbajtësi të llogarisë, një institucion financiar raportues mund të mbështetet në informacionet e mbledhura dhe të mbajtura në përputhje me procedurat për PPP/NJKT.

c) Përcaktimi i rezidencës së një personi kontrollues të një njësie ekonomike jofinanciare pasive. Për qëllime të përcaktimit të rezidencës së një personi kontrollues të një njësie jofinanciare pasive, një institucion financiar raportues duhet të mbështetet në një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë ose e këtij personi kontrollues.

3. Ndryshimi i rrethanave. Nëse ka një ndryshim të rrethanave në lidhje me një llogari të re të njësive ekonomike, që bën që institucioni financiar raportues ta dijë ose të ketë arsye të dijë se vetëdeklarimi ose dokumentacioni tjetër që lidhet me një llogari është i pasaktë ose jo i besueshëm, institucioni financiar raportues duhet të ripërcaktojë statusin e llogarisë në përputhje me procedurat e përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 8.

Rregullat e veçanta të vigjilencës së duhur

Rregullat e mëposhtme aplikohen për zbatimin e procedurave të vigjilencës së duhur të përshkruar më sipër:

1. Mbështetja në vetëdeklarimet dhe evidencat shkresore. Një institucion financiar raportues nuk mund të mbështetet në një vetëdeklarim ose evidencat shkresore, nëse institucioni financiar raportues e di ose ka arsye të dijë se vetëdeklarimi ose evidencat shkresore janë të pasakta ose jo të besueshme.

2. Procedurat alternative për llogaritë financiare të mbajtura nga përfituesit individualë tënjë kontrate të sigurimeve në vlerë në para të gatshme ose të njëkontrate të pensionit vjetor dhe për njëkontratë të sigurimeve në vlerë në para tëgatshme të grupit ose njëkontratë të pensionit vjetor të grupit. Një institucion financiar raportues mund të prezumojëse një përfitues individual (i ndryshëm nga pronari) i një kontrate të sigurimit në vlerë në para të gatshme ose një kontrate pensioni vjetor që merr pension familjar nuk është një person i raportueshëm dhe mund të trajtojë një llogari të tillë financiare ndryshe nga një llogari e raportueshme, përveçsekur institucioni financiar raportues ka njohuri ose arsye për të ditur, që përfituesi është një person i raportueshëm. Një institucion financiar raportues ka arsye të dijë se një përfitues i një kontrate të sigurimit në vlerë në para të gatshme ose një kontrate pensioni vjetor është një person i raportueshëm nëse informacioni i mbledhur nga institucioni financiar raportues dhe i lidhur me përfituesin përmban tregues, siç përshkruhet në pikën 1, të nenit 6. Nëse një institucion financiar raportues ka njohuri reale ose arsye për të ditur, që përfituesi është një person i raportueshëm, institucioni financiar raportues duhet të ndjekë procedurat në pikën 1, të nenit 6.

Një institucion financiar raportues mund të trajtojë një llogari financiare, pjesënë një kontratë të sigurimit në vlerë në para të gatshme grupi ose kontratë të pensionit vjetor grupi si një llogari financiare jo të raportueshme deri në datën në të cilën një shumë do t'i paguhet punonjësit/mbajtësit të certifikatës ose përfituesit, nëse llogaria financiare që bën pjesënë një kontratë të sigurimit në vlerë në para të gatshme të grupit ose kontratë të pensionit vjetor të grupit plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) kontrata e sigurimit në vlerë në para të gatshme të grupit ose kontrata e pensionit vjetor të grupit lidhet nga punëdhënësi dhe mbulon 25 ose më shumë punonjës/mbajtës të certifikatave;

b) punonjësit/mbajtësit e certifikatës kanë të drejtë të marrin ndonjë vlerë të kontratës në lidhje me interesat e tyre dhe të përcaktojnë përfituesit për pensionin që paguhet pas vdekjes së punonjësit; dhe

c) shuma totale që i paguhet çdo punonjësi/mbajtësi të certifikatës ose përfituesit nuk tejkalon shumën 1 000 000 USD (një milion dollarë).

3. Mbledhja e balancave të llogarisë dhe rregullat e monedhës.

a) Mbledhja ellogarive individuale. Për qëllime të përcaktimit të balancës ose të vlerës totale të llogarive financiare të mbajtura nga një individ, një institucion financiar raportues kërkohet të mbledhë të gjitha llogaritë financiare të mbajtura nga institucioni financiar raportues ose nga një njësi ekonomike e lidhur me të, por vetëm deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të institucionit financiar raportuesi lidhin llogaritë financiare, duke iu referuar një elementi të të dhënave si numri i klientit ose TIN- i dhe lejojnë që balancat ellogarive ose vlerat të mblidhen. Çdombajtësi të një llogarie financiare të mbajtur së bashku do t'i atribuohet e gjithëbalanca ose vlera e llogarisë financiare të mbajtur së bashku për qëllime të zbatimit të kërkesave të mblidhjes të përshkruara në këtë paragraf.

b) Mbledhja ellogarive të njësisë ekonomike. Për qëllime të përcaktimit të balancës ose të vlerës së llogarive financiare të mbajtura nga një njësi ekonomike, një institucion financiar raportues i kërkohet të marrë parasysh të gjitha llogaritë financiare që mbahen nga institucioni financiar raportues ose nga një njësi ekonomike elidhur me të, por vetëm deri në masën që

sistemet e kompjuterizuara të institucionit financiar raportues i lidhin llogaritë financiare, duke iu referuar një elementi të të dhënave, si numri i klientit ose TIN-i dhe lejojnë që vlerat e llogarive të mblidhen. Çdombajtësi të një llogarie financiare të mbajtur së bashku do t'i atribuohet e gjithë gjendja ose vlera e llogarisë financiare, për qëllime të zbatimit të kërkesave të mbledhjes të përshkruara në këtë paragraf.

c) Rregullat veçantë embledhjesqë zbatohet për menaxherët e marrëdhënieve. Për qëllime të përcaktimit të balancës ose të vlerësë llogarive financiare të mbajtura nga një person për të përcaktuar nëse një llogari financiare është një llogari me vlerë të lartë, kërkohet, gjithashtu, një institucion financiar raportues, në rastin e llogarive financiare që një menaxher i marrëdhënieve e di, ose ka arsye të dijë, që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të kontrolluar, ose të krijuara (përveç atyre me mirëbesim) nga i njëjti person, për t'i mbledhur të gjitha këto llogari.

4. Shumat e lexuara për të përfshirë ekuivalentin në monedha të tjera. Të gjitha shumat në dollarë janë në dollarë amerikanë dhe do të lexohen duke përfshirë shuma ekuivalente në monedha të tjera, siç përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm. Në përcaktimin e gjendjes ose vlerës së një llogarie të shprehur në një monedhë (përveç dollarëve amerikanë) për qëllimet e këtij vendimi, institucioni financiar do të konvertojë vlerën kufi të dollarëve amerikanë të përshkruar në këto rregulla në monedhën tjetër, duke iu referuar kursit të këmbimit në datën për të cilën institucioni po përcakton shumat kufi.

5. Llogaritë me balancë/gjendje negative. Një llogari me një balancë/gjendje ose vlerë që është negative konsiderohet se ka një balancë/gjendje ose vlerë të barabartë me zero.

Neni 11

Rregulla plotësuese të raportimit dhe të vigjilencës së duhur lidhur me informacionin mbi llogaritë financiare

Rregulla plotësuese të raportimit dhe të vigjilencës së duhur lidhur me informacionin mbi llogaritë financiare:

1. Ndryshimet në rrethana

1.1 “Ndryshimi i rrethanave” përfshin çdo ndryshim që sjell një ndryshim informacioni në lidhje me statusin e një personi ose qëbie ndesh me statusin e personit. Gjithashtu, një ndryshim i rrethanave përfshin çdo ndryshim ose shtim të informacionit në llogarinë e mbajtësit të llogarisë (duke përfshirë edhe shtimin, zëvendësimin ose ndryshimin e mbajtësit të llogarisë) ose çdo ndryshim ose shtim të informacionit në ndonjë llogari të lidhur me këtë llogari (duke aplikuar rregullat e mbledhjes së llogarive të përshkruara në pikën 3, të nenit 10, nëse ndryshimi ose shtimi i informacionit ndikon në statusin e mbajtësit të llogarisë).

1.2 Nëse një institucion financiar raportues është mbështetur në testin e rezidencës, siç parashikohet edhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 6, dhe ka ndryshime në rrethanat që shkaktojnë që institucioni financiar raportues të dijë ose të ketë arsye të dijë që evidencat shkresore fillestare janë të pasakta ose jo të besueshme, institucioni financiar raportues duhet të marrë vetëdeklarim dhe evidenca të reja shkresore për të përcaktuar rezidencën për qëllime tatimore të mbajtësittë llogarisë, jo më vonë se:

a) dita e fundit të vitit përkatës kalendarik; ose

b) 90 ditë kalendarike nga njoftimi ose zbulimi i këtij ndryshiminë rrethana.

Nëse institucioni financiar raportues nuk mund të marrë vetëdeklarimin dhe evidencat e reja shkresore, brenda afatit institucioni financiar raportues, duhet të zbatojë procedurën e kërkimit në formë elektronike të të dhënave, sipas përshkrimit në shkronjave “b” deri në “dh”, të pikës 2, të nenit 6.

2. Vetëdeklarim për llogaritë e reja të njësisë ekonomike. Për sa u përket llogarive të reja të njësisë ekonomike, për qëllime të përcaktimit nëse një person kontrollues i një NFE-je pasiv është një person i raportueshëm, një institucion financiar raportues mund të mbështetet vetëm në një vetëdeklarim nga mbajtësi i llogarisë ose personi kontrollues.

3. Rezidenca e institucionit financiar. Një institucion financiar është rezident në një juridiksion pjesëmarrës nëse ai është nën juridiksionin e një juridiksioni të tillë që mundet të imponojë raportimin nga institucioni financiar.

3.1 Në rastin e një trusti që është një institucion financiar (pavarësisht nëse ai është rezident për qëllime tatimore në një juridiksion pjesëmarrës), trusti i nënshtrohet juridiksionit të një juridiksioni pjesëmarrës në qoftë se një ose më shumë nga administratorët e tij janë rezidentë në juridiksionin tjetër, me përjashtim të rasteve kur trusti i raporton të gjitha informacionet e kërkuara për t'u raportuar në zbatim të këtij vendimi në lidhje me llogaritë raportuese të mbajtura nga trusti në një tjetër juridiksion pjesëmarrës, sepse është rezident për qëllime tatimore në këtë juridiksion tjetër.

3.2 Kur një institucion financiar (përveç një trusti) nuk ka rezidencën për qëllime tatimore (p.sh., sepse trajtohet si transparent nga ana fiskale ose ndodhet në një juridiksion që nuk aplikon tatimin mbi të ardhurat), konsiderohet të jetë subjekt i juridiksionit në një juridiksion pjesëmarrës, nëse:

a) është themeluar sipas ligjeve të juridiksionit pjesëmarrës;

b) ka vendin e tij të menaxhimit (duke përfshirë menaxhimin efektiv) në juridiksionin pjesëmarrës; ose

c) i nënshtrohet mbikëqyrjes financiare në juridiksionin pjesëmarrës.

3.3 Kur një institucion financiar (përveç një trusti) është rezident në dy ose më shumë juridiksione pjesëmarrëse, ky institucion financiar do t'u nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe vigjilencës së duhur sipas juridiksionit pjesëmarrës në të cilin mban llogaritë financiare.

4. Mbajtja e llogarisë. Në përgjithësi, një llogari do të konsiderohet se mbahet nga një institucion financiar në rastet e mëposhtme:

a) në rastin e një llogarie të kujdestarisë, nga institucioni financiar që ka kujdestarinë mbi aktivet e llogarisë (duke përfshirë një institucion financiar që mban aktive në emër të mbajtësit të llogarisë në një institucion të tillë);

b) në rastin e një llogarie depozitë, nga institucioni financiar i cili është i detyruar të kryejëpagesa në lidhje me llogarinë (përjashtuar një agjent të një institucioni financiar pavarësisht nëse një agjent i tillë është një institucion financiar);

c) në rastin e ndonjë interesi ose borxhit të kapitalit në një institucion financiar që përbën një llogari financiare, nga ky institucion financiar;

ç) në rastin e një kontrate sigurimi në vlerë në para të gatshme ose të një kontrate të pensionit vjetor, nga institucioni financiar që është i detyruar të kryejëpagesa në lidhje me kontratën.

5. Trustet që janë njësi jofinanciare pasive. Një njësi ekonomike si një shoqëri, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose një formë e ngjashme e organizimit që nuk ka rezidencën për qëllime tatimore, sipas pikës 49, të nenit 3, trajtohet si rezident në juridiksionin në të cilin ushtron efektivisht veprimtarinë. Për këto qëllime, një person juridik ose një formë ligjore e ngjashme e organizimit konsiderohet "i ngjashëm" me një partneritet dhe me një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ku nuk trajtohet si një njësi e tatueshme në një juridiksion pjesëmarrës, sipas legjislacionit tatimor të këtij juridiksioni. Megjithatë, për të shmangur raportimin e dyfishtë (duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë të "personave kontrollues" në rastin e trusteve), një trust që është një NFE pasiv nuk mund të konsiderohet si një formë ligjore e ngjashme organizimi.

6. Adresa e selisë qendrore të njësisë ekonomike

6.1 Një nga kërkesat e përshkruara në shkronjën "c", të pikës 5, të nenit 3, është që, në lidhje me një njësi ekonomike, dokumentacioni zyrtar të përfshijë ose adresën kryesore të zyrave të njësisë ekonomike në një juridiksion ku pretendon se është rezident ose një juridiksion në të cilin njësi ekonomike është themeluar. Adresa kryesore e një njësie ekonomike është adresa ku menaxhohet efektivisht.

6.2 Adresa e një institucioni financiar në të cilin njësi ekonomike mban një llogari, një kuti postare ose një adresë të cilën e përdor vetëm për qëllime postimi nuk është adresa e selisë qendrore të njësisë ekonomike, përveçse kur kjo adresë është adresa e vetme e përdorur nga

njësia ekonomike dhe paraqitet si adresa e regjistruar e njësisë ekonomike në të gjitha dokumentet zyrtare.

6.3 Adresa e cila është përcaktuar për të mbajtur të gjithë postën në atë adresë nuk përfaqëson adresën e selisë kryesore të njësisë ekonomike.

Neni 12

Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme

1. Çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë i raporton Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacionin mbi llogaritë e raportueshme, sipas shtojcës IV bashkëlidhur “Metodat e transferimit të të dhënave nga institucionet financiare të detyruar për të komunikuar me administratën tatimore, në kuadër të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare”.

2. Autoriteti kompetent, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, shkëmben me administratat e tjera tatimore informacionin e marrë nga institucionet financiare raportuese nëpërmjet sistemit CTS. Ky sistem, i cili aksesohet kundrejt një tarife vjetore, do të mundësojë transmetimin/pranimin e mesazheve dhe të integrimin me sistemet e autoriteteve të tjera tatimore.

3. Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme duhet të realizohet duke respektuar parimin e mjaftueshmërisë, proporcionalitetit dhe afatit të përpunimit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Gjatë procesit të shkëmbimit të informacionit mbi llogaritë e raportueshme duhet të garantohen masat e sigurisë së të dhënave personale, evidentimi i gjurmimit të përpunimit të të dhënave personale dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave/tatimpaguesve.

Neni 13

Dispozita të fundit

Ngarkohet administrata tatimore dhe subjektet e përcaktuara në ligjin nr.4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar në FZ. 145/2020

Dale nga shtypi 07.08.2020

SHTOJCA I
LISTA E JURIDIKSIONEVE PJESËMARRËSE

1. Albania
2. Argentina
3. Andorra
4. Australia
5. Austria
6. Anguilla
7. Antigua and Barbuda
8. Aruba
9. Azerbaijan
10. Belgium
11. Bulgaria
12. Brazil
13. Bermuda
14. British Virgin Islands
15. Bahamas
16. Bahrain
17. Barbados
18. Belize
19. Brunei
20. Colombia
21. Croatia
22. Cyprus
23. Czech Republic
24. Canada
25. Chile
26. China
27. Cayman Islands
28. Cook Islands
29. Costa Rica
30. Curaçao
31. Denmark
32. Dominica
33. Ecuador
34. Estonia
35. Faroe Islands
36. Finland
37. France
38. Germany
39. Gibraltar
40. Greece
41. Guernsey
42. Greenland
43. Grenada

44. Ghana
45. Hungary
46. Hong Kong (China)
47. Iceland
48. India
49. Ireland
50. Isle of Man
51. Italy
52. Israel
53. Indonesia
54. Japan
55. Jersey
56. Kazakhstan
57. Korea
58. Kuwait
59. Latvia
60. Liberia
61. Liechtenstein
62. Lithuania
63. Luxembourg
64. Lebanon
65. Montserrat
66. Macau (China)
67. Marshall Islands
68. Malta
69. Mexico
70. Malaysia
71. Mauritius
72. Monaco
73. Morocco
74. Netherlands
75. Norway
76. Neë Zealand
77. Nauru
78. Niue
79. Nigeria
80. Oman
81. Poland
82. Portugal
83. Pakistan
84. Panama
85. Qatar
86. Romania
87. Russia
88. San Marino

89. Seychelles
90. Slovak Republic
91. Slovenia
92. South Africa
93. Saint Kitts and Nevis
94. Saint Lucia
95. Saint Vincent and the Grenadines
96. Samoa
97. Spain
98. Sweden
99. Saudi Arabia
100. Singapore
101. Sint Maarten
102. Switzerland
103. Turkey
104. Turks and Caicos Islands
105. United Kingdom
106. United Arab Emirates
107. Uruguay
108. Vanuatu

SHTOJCA II
LISTA E JURIDIKSIONEVE TË RAPORTUESHME

1. Albania
2. Argentina
3. Andorra
4. Australia
5. Austria
6. Antigua and Barbuda
7. Azerbaijan
8. Belgium
9. Bulgaria
10. Brazil
11. Barbados
12. Colombia
13. Croatia
14. Cyprus
15. Czech Republic
16. Canada
17. Chile
18. China
19. Cook Islands
20. Costa Rica
21. Denmark

22. Ecuador
23. Estonia
24. Faroe Islands
25. Finland
26. France
27. Germany
28. Gibraltar
29. Greece
30. Guernsey
31. Greenland
32. Grenada
33. Hungary
34. Hong Kong (China)
35. Iceland
36. India
37. Ireland
38. Isle of Man
39. Italy
40. Israel
41. Indonesia
42. Japan
43. Jersey
44. Kazakhstan
45. Korea
46. Latvia
47. Liberia
48. Liechtenstein
49. Lithuania
50. Luxembourg
51. Malta
52. Mexico
53. Malaysia
54. Mauritius
55. Monaco
56. Morocco
57. Netherlands
58. Norway
59. New Zealand
60. Nigeria
61. Oman
62. Poland
63. Portugal
64. Pakistan
65. Panama
66. Russia

67. San Marino
68. Seychelles
69. Slovak Republic
70. Slovenia
71. South Africa
72. Saint Kitts and Nevis
73. Saint Lucia
74. Spain
75. Sweden
76. Saudi Arabia
77. Singapore
78. Sëitserland
79. Turkey
80. Turks and Caicos Islands
81. United Kingdom
82. Uruguay

SHTOJCA III LISTA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JORAPORTUESE

1. Një organ qeveritar, organizatë ndërkombëtare ose bankë qendrore, përveçse lidhur me pagesa të cilat rrjedhin nga detyrimet e mbajtura, në lidhje me një veprimtari financiare tregtare të llojit të atyre të realizuara nga një Shoqëri sigurimesh e specifikuar, një institucion kujdestarie ose një institucion depozite.

2. Një fond pensioni me pjesëmarrje të gjerë; një fond pensioni me pjesëmarrje të kufizuar; një fond pensioni i një organi qeveritar, organizate ndërkombëtare ose banke qendrore ose një emetues i kualifikuar i kartave të kreditit.

3. Çdo njësi tjetër ekonomike që paraqet rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore, ka shumë karakteristika të ngjashme me secilën prej njësive të përshkruara në paragrafët "a" dhe "b", të pikës 49, të nenit 3 dhe është përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si një institucion financiar joraportues, me kusht që statusi i kësaj njësie si institucion financiar joraportues nuk cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

4. Një instrument investimesh kolektive i përjashtuar.

5. Një trust deri në masën që administratori i besuar i trustit është një institucion financiar raportues dhe e raporton të gjithë informacionin që duhet raportuar në përputhje me nenin 4, lidhur me të gjitha llogaritë e raportueshme të trustit.